

Mbani parasysh:

- Kushdo mund të sëmuret nga kanceri në gji. Mirëpo me rritjen e moshës tuaj rriten edhe mundësitë që të prekeni nga kjo sëmundje.
- Përmes mamogramit mund të zbulohen edhe raste kur kanceri i gjirit është ende i vogël.
- Nëse kanceri i gjirit zbulohet kur është ende i vogël dhe para se të përhapet, atëherë është më i kollajshëm për t'u trajtuar.

Hapat që duhet të ndërmarr për të mbrojtur shëndetin:

- Do të marr në telefon numrin **1-800-227-2345**, për të mësuar më shumë për mamogramin dhe kancerin në gji.
- Do të pyes doktorin dhe infermierin se si mund të kryej edhe unë mamogramin.
- Do të caktoj datën për kryerjen e mamogramit
- Do të telefonoj nëse nuk kam marrë rezultatet e mamogramit.

Për informacion në lidhje me kancerin, për ndihmën që ofrohet çdo ditë dhe për mbështetjen emocionale, merrni në telefon Shoqatën Amerikane të Kancerit, tek numri 1-800-227-2345. Ne jemi këtu kurdoherë që të keni nevojë për ne - 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.



cancer.org | 1.800.227.2345
1.866.228.4327 TTY



Shkruar në Korrik 2016

©2008, American Cancer Society, Inc.
No. 202811 Rev. 7/16
Modelet përdoren vetëm si ilustrim.



Le të flasim për Mamogramin

*Let's Talk About Mammograms
Albanian*



cancer.org | 1.800.227.2345



Mimoza: *Wow – sapo mbusha 45 vjeç dhe erdhi momenti për të bërë mamogramin tim.*

Anila: *Unë për vete e kam shtyrë: kam frikë të marr vesh se ç'mund të kem.*

Mimoza: *Të kuptoj se ç'do të thuash. Por nëse kam kancer në gji, do të preferoja ta zbuloja kur të ishte ende i vogël. Në këtë rast shanset që kam për të jetuar dhe për të mos humbur gjoksin tim janë ende të mira. Unë dua të kujdesem për shëndetin tim - familja ime ka nevojë për mua.*

Anila: *Kjo që thua ka kuptim për mua. Edhe unë dua ta marr vesh dhe të jetoj!*

Pse duhet ta kryej mamogramin?

- Me rritjen e moshës rritet edhe probabiliteti për t'u sëmurur me kancer në gji. Ka raste kur kanceri në gji shfaqet edhe pas menopauzës.
- Edhe nëse nuk pësoni ndryshime ose nuk keni gjëndra në gjinjtë tuaj, ju duhet që të kryeni rregullisht mamogramet.
- Edhe në rast se në familjen tuaj nuk ka raste të kancerit në gji, ju prapëseprapë keni nevojë të kryeni mamogramin.
- Edhe në rast se keni kancer në gji, zbulimi i hershëm i tij mund t'ju ndihmojë që të jetoni dhe të bëni gjërat që janë të rëndësishme për ju.

Kam dëgjuar se të shkakton dhimbje.

Kur pjatat e aparatit shtypin gjinjtë tuaj, ky "shtrëngim" mund t'ju shkaktojë dhimbje për një minutë. Disa gra thonë se shkakton dhimbje; kurse disa të tjera thonë se nuk të dhemb fare.

Çfarë ndodh nëse zbulojnë diçka?

Nëse mamogrami tregon diçka, kjo nuk do të thotë se ju keni kancer në gji. Ju mund të keni nevojë të bëni radiografi ose teste të tjera. Pas kësaj mjeku tuaj mund të rekomandojë planin më të përshtatshëm për ju.

Sa kushton një mamogram?

Shumica e planeve të sigurimit shëndetësor dhe Medicare e mbulojnë koston e mamogramit. Në qoftë se keni Medicaid ose nuk jeni i mbuluar me sigurim shëndetësor, ju mund të kryeni mamogramin falas në shtetin tuaj. Interesohuni tek departamenti tuaj i shëndetësisë.

Për të kryer mamogramin duhet të lidhem me:

- Doktorin ose infermierin tim
- Qendrën time shëndetësore ose klinikën e grave
- Merrni në telefon Shoqatën Amerikane të Kancerit tek 1-800-227-2345 dhe kërkoni informacion se si mund ta kryeni mamogramin në qendrën e banimit tuaj.

Çfarë është mamogrami?

Mamogrami është radiografi e gjinjve tuaj. Nëpërmjet atij mund të zbulohen ndryshime që janë tepër të vogla për të kapur nga mjeku ose infermieri tuaj.

Si kryhet mamogrami?

Ju rrini përballë instrumentit të radiografisë dhe vendosni gjinjtë tuaj midis dy pllakave plastike. Këto pllaka shtypin gjinjtë duke i sheshuar ato me qëllim që të sigurohet një foto sa më e mirë.

